

BULETINI 2025



KOMUNA E LIPJANIT



Dhjetor

Betohet Imri Ahmeti, irizgjedhur për herë të katërt Kryetar i Komunës së Lipjanit



Në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit, u mbajt Seanca Inauguruese, në të cilën u bë betimi i Kryetarit të Komunës, z. Imri Ahmeti, para anëtarëve të rinj të Kuvendit dhe mysafirëve të pranishëm.

Mbledhja u drejtua nga anëtari më i vjetër i Kuvendit, z. Nexhmedin Lekiqi nga radhët e LDK-së. Gjatë seancës u bë betimi i 31 anëtarëve të rinj të Kuvendit, të zgjedhur në zgjedhjet lokale të mbajtura më 12 tetor 2025. Ndërsa, me 16 vota për, z. Daut Azemi u zgjodh kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit.

Në fjalimin e tij pas betimit, Kryetari Ahmeti shprehu mirënjohje dhe përkushtim për mandatin e ri, duke theksuar vlerësimin ndaj besimit që qytetarët i kanë dhënë për herë të katërt radhazi.

“Sot po fillojmë mandatin e ri me besimin e qytetarëve. Me përlësi dhe mirënjohje të thellë, i falënderoj të gjithë. Besimi për mandatin e katërt është nder i madh për mua dhe më motivon të punoj me ndershmëri, transparencë dhe përkushtim në shërbim të çdo familjeje, çdo lagjeje dhe çdo fshati të komunës sonë”, tha Kryetari z. Imri Ahmeti.

Ai shtoi se rezultati zgjedhor është përgjegjësi e madhe dhe nxitje për të vazhduar projektet zhvillimore që synojnë modernizimin dhe përparimin e Komunës së Lipjanit.

Në përmbyllje të fjalimit, Kryetari Ahmeti falënderoi qytetarët për mbështetjen e vazhdueshme. “Faleminderit nga zemra, Lipjan”.


Lipjani Festiv



Në Sheshin "Adem Jashari", Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorë dhe qytetarë të shumtë, ndezën dritat e pemës së Vitit të Ri, duke krijuar një atmosferë të ngrohtë festive.

Qyteti i Lipjanit mori pamjen e tij magjike, duke shënuar zyrtarisht fillimin e festave të fundvitit .

Homazhe në nderim të katër dëshmorëve të fshatit Krojmir



Në shenjë nderimi të 27-vjetorit të rënies së katër dëshmorëve të fshatit Krojmir, Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, së bashku me bashkëpunëtorët, bëri homazhe dhe vendosi kurora lulesh pranë kompleksit memorial “Katër Dëshmorët” në fshatin Krojmir.

Dëshmorët e fshatit Krojmir, Isa Olluri, Qamil Olluri dhe Enver Olluri, ranë heroikisht në Betejën e Pashtrikut, së bashku me komandantin Mujë Krasniqi. E poashtu edhe dëshmori Bashkim Krasniqi nga fshati Zllakuqan, duke dhënë jetën për lirinë e vendit.

Nënkryetari Bytyqi theksoi se nderimi dhe kujtimi i dëshmorëve përbëjnë një udhërrëfyes të përhershëm në rrugëtimin e popullit tonë drejt lirisë. Ai shtoi se rënia e tyre heroike përfaqëson themelin mbi të cilin është ndërtuar liria dhe demokracia që sot e gëzojmë të gjithë.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, i shoqëruar nga Nënkryetari z. Diamant Bytyqi, kanë pritur në takim përfaqësueset e Këshillit të Evropës në Prishtinë, znj. Mary Ann Hennessey dhe znj. Sakibe Jashari, përfaqësuese e projektit.



Temë e diskutimit ishte promovimi i transparencës përmes projektit “Ekrani i Qytetarit”, i vendosur tashmë në objektin e Komunës së Lipjanit, si projekt i përbashkët ndërmjet Këshillit të Evropës dhe Komunës së Lipjanit. Përmes këtij ekrani, qytetarët përveç informimit për aktivitetet e komunës dhe shërbimet e tjera komunale, mund të pajisen edhe me dokumente personale përmes platformës e-Kosova.

Kryetari Ahmeti ka shprehur mirënjohje për përfaqësueset e Këshillit të Evropës për angazhimin e përbashkët, me shpresën që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen.

“Si institucion komunal, jemi të përkushtuar që ta avancojmë edhe më tej transparencën dhe llogaridhënien. Andaj edhe projekti i fundit i përbashkët me Këshillin e Evropës, ‘Ekrani i Qytetarit’, do të kontribuojë në rritjen e mëtejme të transparencës ndaj qytetarëve”, ka thënë Kryetari Ahmeti, duke u shprehur i gatshëm të angazhohet edhe në agjenda të tjera që rrisin pjesëmarrjen qytetare. Nga ana tjetër, znj. Mary Ann Hennessey, Shefe e Zyrës së Këshillit të Evropës në Prishtinë, ka përgëzuar Kryetarin Imri Ahmeti dhe ekipin e tij për implementimin e standardeve që rrisin transparencën. Ajo gjithashtu ka theksuar se bashkëpunimi me Komunën e Lipjanit është i lehtë dhe shumë i mirë.

U mbajt mbledhja e 2-të me radhë e Kuvendit të Komunës së Lipjanit



Kuvendi i Komunës së Lipjanit, i udhëhequr nga Kryesuesi, z. Daut Azemi, zhvilloi punimet e mbledhjes së 2-të me radhë, ku u shqyrtuan dhe u miratuan pikat e rendit të ditës, të cilat ishin propozuar për këtë seancë.

Nënkryetari i Komunës së Lipjanit, z. Diamant Bytyqi, gjatë kësaj seance ka dhënë sqarime për të gjitha pyetjet dhe çështjet e ngritura nga anëtarët e Kuvendit të Komunës. Gjatë punimeve të kësaj seance u miratuan këto pika të rendit të ditës:

Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Propozim vendim për themelimin e Komitetit për Komunitete.

Raporti i performancës së Komunës së Lipjanit për vitin 2025.

Raporti i zbatimit të Planit të Integritetit në Komunën e Lipjanit për periudhën janar–dhjetor 2025.

Propozim vendim për anulimin e Vendimit 15NR.462/01-27002 të datës 29.05.2025 për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit 1NR.464-47684 të datës 29.09.2015 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të Komunës në ZK-Babush i Muhaxherëve.

Propozim vendim për miratimin e Planit orientues të punës së Kuvendit të Komunës së Lipjanit për vitin 2026.

Raporti i auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Lipjanit për vitin 2024 dhe Plani i zbatimit të rekomandimeve të auditorit, të pranuar me raportin final nga Auditori i Zyrës Kombëtare të Kosovës për vitin 2024, të cilin auditim e ka kryer Zyra Kombëtare e Auditimit.

Raporti vjetor i NJAB-së për vitin 2024.

Shpërndahen pajisje bujqësore për fermerët e Komunës së Lipjanit



Komuna e Lipjanit ka realizuar shpërndarjen e pajisjeve bujqësore për fermerët e komunës, në kuadër të mbështetjes së vazhdueshme për zhvillimin e sektorit të bujqësisë.

Me këtë rast, Kryetari i Komunës, z. Imri Ahmeti, theksoi se Komuna e Lipjanit është ndër komunat që mbështet më së shumti fermerët përmes pajisjeve dhe investimeve konkrete, me qëllim të rritjes së prodhimtarisë bujqësore dhe përmirësimit të kushteve të punës për fermerët lokalë.

“Investimi te fermerët është investim i drejtpërdrejtë në zhvillimin e ekonomisë lokale dhe në fuqizimin e prodhimit vendor”, tha Kryetari z. Imri Ahmeti, duke u uruar fermerëve punë të mbarë në aktivitetet e tyre bujqësore.

Komuna e Lipjanit mbetet e përkushtuar që përmes mbështetjes me pajisje bujqësore, të vazhdojë përkrahjen për fermerët dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të bujqësisë në komunë.

Kryetari Ahmeti mbajti takim publik me qytetarët



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, në sallën e Kuvendit Komunal, në përmbyllje të vitit 2025, mbajti një takim publik me qytetarë, të cilët i njoftoi për punët e realizuara, sfidat dhe të arriturat e komunës gjatë këtij viti që po e lëmë pas.

Kryetari Ahmeti u shpreh i kënaqur për trendin e investimeve të realizuara gjatë vitit 2025, e të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së qytetarëve të Komunës së Lipjanit. Ai e cilësoi vitin 2025 si një vit shumë të suksesshëm, duke ia atribuar këtë sukses qytetarëve të Lipjanit për bashkëpunimin e ndërsjellët.

Gjatë takimit me qytetarë, Kryetari Ahmeti vlerësoi të kënaqshëm realizimin e buxhetit të komunës për vitin 2025, i cili ka qenë i suksesshëm dhe se deri në fund të vitit pritet të arrijë deri në 95% të realizimit; investimet kapitale kanë arritur rreth 76% të realizimit. Ndërsa, të hyrat vetanake kanë shënuar progres të jashtëzakonshëm, duke tejkaluar planifikimin buxhetor.

“Deri më tani kemi realizuar mbi 60 projekte, por po i veçoj disa nga më të rëndësishmet, si: ndërtimi i QKMF-së në Lipjan, e cila sigurisht që do t’i përmirësojë kushtet dhe shërbimet për qytetarët tanë, ndërtimi i Shtëpisë së Kulturës, ndërtimi i vazhdimit të sheshit dhe parkut të qytetit, renovime të shkollave, asfaltime të rrugëve e shumë projekte të tjera”, tha Kryetari Ahmeti.

Qytetarët e pranishëm në takim shprehën mirënjohje për angazhimin e Kryetarit Ahmeti dhe kabinetit të tij për realizimin e projekteve të shumta që kanë ndikuar pozitivisht në zhvillimin e komunës.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, ka organizuar ceremoninë tashmë tradicionale për përmbylljen e vitit 2025



Gjatë kësaj ceremonie, Kryetari Ahmeti falënderoi përfaqësuesit institucionalë, organizatat partnere vendore dhe ndërkombëtare, Policinë e Kosovës, Bashkësinë Islame në Lipjan, komunitetin e biznesit, si dhe qytetarët e Komunës së Lipjanit për bashkëpunimin dhe kontributin e tyre të vazhdueshëm. Duke folur për arritjet e vitit që po mbyllet, Kryetari Ahmeti e vlerësoi vitin 2025 si një periudhë me rezultate të rëndësishme, duke theksuar investimet në projekte infrastrukturore, si dhe mbështetjen konkrete për sportin, shoqërinë civile dhe sektorin e bujqësisë, përmes subvencionimit të pajisjeve bujqësore dhe mjeteve të tjera.

“Qytetarët e Lipjanit kanë qenë partnerët tanë kryesorë në këtë rrugëtim. Së bashku kemi ndërtuar një bazë të fortë për të vazhduar zhvillimin e komunës sonë,” tha Kryetari z. Imri Ahmeti. Në përmbyllje të këtij organizimi, Kryetari Ahmeti uroi të gjithë qytetarët për festat e fundvitit dhe i ftoi ata që edhe në të ardhmen të vazhdojnë të kontribuojnë në zhvillimin e qytetit dhe vendbanimeve të Komunës së Lipjanit, duke nënvizuar rëndësinë e bashkëpunimit të vazhdueshëm. Ceremonia u përmbyll me shfaqjen e një reportazhi informues të përgatitur nga Sektori për Marrëdhënie me Publikun, i cili përmbledh projektet dhe punët kryesore të realizuara nga Komuna e Lipjanit gjatë vitit 2025.

Kryetari Ahmeti nderon me homazhe heroin Lulzim Morina



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët e tij, me rastin e 25-vjetorit të ndarjes nga jeta të Komandantit të UÇK-së, Lulzim Morina (Komandant Luli), nga Brigada “135 Agim Zeneli”, ka bërë homazhe dhe ka vendosur kurora lulesh pranë lapidarit të tij në fshatin Hallaq i Vogël, në nderim të jetës dhe veprës së tij. Me këtë rast, kryetari Ahmeti u shpreh se përkujtimi dhe respekti ndaj heronjve si Komandant Luli janë një detyrim dhe nder i vazhdueshëm, pasi ata dhanë gjithçka për lirinë që gëzojmë sot. Ai shtoi se jeta dhe vepra e tij do të mbeten përjetësisht frymëzim për brezat e tashëm dhe ata të ardhshëm.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët, ka lansuar në funksion ndriçimin publik në parkun e ri mbi parkingun nëntokësor si dhe në vazhdimin e sheshit “Adem Jashari”, projekte këto me rëndësi për përmirësimin e hapësirave publike në qytetin e Lipjanit.



Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, së bashku me bashkëpunëtorët, ka lansuar në funksion ndriçimin publik në parkun e ri mbi parkingun nëntokësor si dhe në vazhdimin e sheshit “Adem Jashari”, projekte këto me rëndësi për përmirësimin e hapësirave publike në qytetin e Lipjanit.

Me këtë rast, janë ndezur dritat e parkut dhe sheshit, duke i dhënë parkut të ri një pamje më moderne, në funksion të përdorimit më të mirë dhe më të sigurt të hapësirës publike.

Kryetari i Komunës së Lipjanit, z. Imri Ahmeti, uron të gjithë qytetarët me rastin e Vitit të Ri, duke reflektuar mbi punën e bërë, besimin e qytetarëve dhe përgjegjësinë për vazhdimin e zhvillimit të komunës në vitet e ardhshme.



Të dashur qytetarë,

Në prag të ndërrimit të viteve, ndalemi për të reflektuar mbi rrugën e bërë dhe për të marrë përgjegjësinë për hapat që na presin përpara. Çdo hap që kemi ndërmarrë deri më sot ka qenë rezultat i bashkëpunimit, durimit dhe besimit tuaj. Ky besim na ka dëshmuar se sfidat nuk na ndalin, por na forcojnë dhe na bëjnë më të vendosur për të ecur përpara.

Besimi i ripërtërirë për katër vitet e ardhshme nuk është privilegj, por obligim i madh. Një obligim për ta dëshmuar çdo ditë me punë konkrete, zhvillim të qëndrueshëm dhe vendime që ndikojnë drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës së çdo qytetari, pa dallim.

Le ta nisim Vitin e Ri me vendosmëri dhe unitet, të bindur se e ardhmja ndërtohet me punë të ndershme dhe angazhim të vazhdueshëm. Së bashku vizionin mund ta shndërrojmë në realitet dhe shpresën në zhvillim të prekshëm për Lipjanin.

Gëzuar Vitin e Ri 2026!

Ju uroj shëndet, mbarësi dhe suksese për ju dhe familjet tuaja.

Me respekt dhe mirënjohje,

Imri Ahmeti

Kryetar i Komunës së Lipjanit



Komuna e Lipjanit – Zyra për informim



<https://lipjan.rks-gov.net/>



infokomuna.lipjan@rks-gov.net



0 800 14 000 / 038 200 41 508